



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**VENDIM**  
**Nr. 3, datë 31.01.2023**  
**PËR**  
**RINOVIMIN PËR NJË PERIUDHË NJË VJEÇARE TË KONTRATAVE ME**  
**BANKAT AGJENTE TË PËRZGJEDHURA NË LISTËN PARAPRAKE**  
**PËR VITIN 2023**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 42, pika 7 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 25, pika 2, pika 4 dhe pika 5 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.07.2016, si dhe vendimit qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 39, datë 15.12.2020 “Mbi përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake për periudhën 2021-2023”, të nenit 18 të rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Të rinovojë për një periudhë 1 (një) vjeçare kontratat me bankat agjente të përzgjedhura në listën paraprake për vitin 2023, si vijon:
  - Banka Kombëtare Tregtare SHA;
  - Banka Credins SHA;
  - Banka Intesa San Paolo SHA.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë bankat e përzgjedhura në listën paraprake, si dhe Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

